



## Si ju mund të kontriboni që fëmiju të ndjehet i sigurtë në kopsht/çerdhe?

### Para fillimit:

- Kontakto me kopshtin/çerdhen për me caktue termin për vizitë
- Përgatitni fëmijën tuaj duke folur pozitivisht për kopshtin/çerdhen
- Jap informacion për rutinat e fëmijës.
- Përdor vendin e lojës së kopshtit/çerdhes kur është i mbyllur në vikende

### Kur fillon në kopsht/çerdhe:

- Gjej kohë për të qëndruar së bashku me fëmijën në kopsht/çerdhe deri sa fëmiju të ndihet mjaft i sigurtë kështu që ju mund të largoheni
- Tregoni stafit se si ata mund ta kuptojnë fëmijën në mënyrën më të mirë që është e mundshme para se fëmija të jetë në gjendje vet të shprehet në menyrë gjuhësore
- Bë përpjekje që fëmija të këtë ditë më të shkurtëra në kopsht/çerdhe në ato katërmbëdhjetë ditët e para, dhe merrni lirisht pushim apo pushim të lehonisë për këtë
- Lereni fëmijën të merr me vete bibiron, ari prej pellushi (lodër), leckë përkedhelse, korrocë apo pajisje tjera që fëmija zakonisht luan me to
- Në qoftë se fëmiju duhet të flej në kopsht/çerdhe, fol me kopshtin/çerdhen për rutinat e gjumit të fëmijut të juaj
- Tregoni stafit për rutinat e fëmijës, lodrat që i interesojnë, ushqim dhe shprehitë e ngrenies, pijes dhe eventualisht faktor tjerë të njohur të sigurisë
- Tregoj gjithmonë fëmijut kur don me shkue
- Fol pozitivisht me fëmijën për stafin dhe kopshtin/çerdhen

## «Më jepni fillim të sigurtë në kopsht/çerdhe»



### ALBANSK

Informacion për prindër për sa i përket fillimit në kopsht/çerdhe

## «Me jepni fillim të sigurtë në kopsh/gerdhe»

Kjo është një broshurë e cila është hartuar për ju që keni fëmijë të cilët do të fillojnë në kopsh/gerdhe. Kjo ju informon juve si prind se çka ju mund të pritni nga kopsh/gerdha para se të filloj dhe kur fillon. Kjo gjithashtu ju jap këshilla profesionale dhe sugjerime se çka është me rëndësi për fëmijun që të këtë një fillim të mirë dhe të sigurtë.

Përshtatje e mirë këtu bëhet fjalë për lidhje dhe krijimin e relacioneve të mira, dhe është parakusht i rëndësishëm për siguri, mirëqenie dhe të mësuar.

Fëmija ka nevojë bazike për siguri, parashikueshmëri dhe stabilitet.

Atyre do tu japim kohë të mjaftueshme për të krijuar relacione dhe për të lidhur kontakt me të gjithë stafin dhe me fëmijët tjerë.

Prindërit duhet të bashkëveprojnë dhe të japin informacion për fëmijun kështu që kopsh/gerdha në mënyrën më të mirë të mundshme të regulloj ashtu që fëmija të këtë atë që ka nevojë.

Kopsh/gerdha mundet ruatim pak me ndryshue, por pa marrë parasysh këtë të gjithë fëmijë dhe prindërit duhet të ndihen të sigurtë dhe të ambjentuara të mirë në kopsh/gerdhe.

## Çfarë mund të presësh nga kopsh/gerdha?

Kopsh/gerdha duhet:

- Të ju ftoj juve në takim për prind në lidhje me pranimin kryesor të fëmijëve të ri në kopsh/gerdhe
- Të ju ftoj ju në vizitë para fillimit në kopsh/gerdhe
- Të ju jap informacion për rutinat e kopsh/gerdhes para fillimit dhe organizimin për tu ambjentuara
- Që të ja zgjedh fëmijës një person të caktuar në kopsh/gerdhe i cili është i caktuar që fëmija të i ndihmon që të njihet me vendin dhe të ndihet i sigurtë
- Me pasë biseda fillestare me ju
- Me pasë një ritëm të përditshëm të parashikuar dhe të përhershëm
- Me pasë kohë të mjaftueshme për përshtatje – duke u nisur nga nevojat e fëmijut
- Me pasë dialog të ngushtë dhe të mirë me ju gjatë përshtatjes
- Me rregullue një fillim të mirë dhe të sigurtë pa marrë parasysh se në çfarë kohë të vitit fëmija fillon

## Cilat janë detyrat e personit që është i caktuar për fëmijun?

Kur fillon në kopsh/gerdhe fëmija duhet të këtë një person të zgjedhur nga stafi në repart apo bazë, dhe që ju mund të ju drejtoheni atij. Ky person do të ndihmon fëmijë që të ndihet i sigurtë duke u përkujdesur për të, me atërsi dhe ngushtëllim, dhe dal nga dal me e prezentue fëmijun me fëmijë tjerë dhe stafin.

Personi që është i caktuar për fëmijun duhet të përkujdeset ndërkohë që të ju informoj se si është fëmija, dhe si po funksionon fëmija në kopsh/gerdhe. Kur personi i caktuar është njohur mirë me fëmijun atëherë është më lehtë për fëmijun me zhvillue relacione të mira me të tjerët në kopsh/gerdhe.